



Agjencia Kosovare e Pronës
SHPLLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE
№ 13/2011

№: 13/2011
Data: 31 Gusht 2011

Ri shpallje

Zyrtar për Asete (pasuri)

ZQ Prishtinë

Niveli: BKK koeficienti 6 (përafërsisht 278.85 € bruto në muaj)

Kohëzgjatja: e Pacaktuar, Pozitë e karrierës (periudha provuese 1 vit)

(№ i referencës: KPA 025/2011)

Kjo pozitë është në Zyrën e Financave të AKP-së. Nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Zyrtarit Kryesor Financiar, personi i përzgjedhur i kryen detyrat në vijim:

- Kryen detyrat e Zyrtarit të Pasurive në përputhje me Udhëzimin Administrativ 21/2009 të MF dhe me Procedurën e Brendshme të AKP-së për Pasuritë;
- Është përgjegjës për mbikëqyrjen, regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive të përgjithshme duke përfshirë të gjitha informacionet e kërkuara sipas UA 21/2009 dhe procedurës së brendshme për menaxhim të pasurive të AKP-së;
- Regjistron të gjitha pasuritë në regjistrin e pasurive të përgjithshme, regjistrin e pasurive të AKP-së dhe në regjistrin e llogarive SIMFK bazuar në faturë dhe dëftesa;
- E siguron për ZKF regjistrin e pasurive të përgjithshme, regjistrin e pasurive të AKP-së dhe regjistrin e llogarive SIMFK, raporton në baza tremujore dhe kur kërkohet;
- Koordinon rastet për të shpallur pasuritë si të humbura, vjedhura, dëmtuara, ose të harxhuara;
- Kryen detyra të tjera që mund t'i caktohen sipas nevojës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet e kërkuara dhe përvoja:

- Diplomë universitare në Ekonomi;
- Dy vjet përvojë profesionale në Financa, e preferueshme në inventar, përcjellje të Pasurive;
- Aftësi të shkëlqyeshme kompjuterike dhe teknike;
- Posedimi i patentë shoferit të vlefshëm, të paktën me dy vjet përvojë në vozitje (dëshmi për vozitjen e sigurt)

Kjo pozitë është përcaktuar si e karrierës në bazë të paragrafit 1.1 të nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilët kanë aftësitë fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

Shënim: Procedura e rekrutimit është e rregulluar me Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatë të jashtëm, si dhe nëpunës civilë ekzistues.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimin për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Detajet lidhur me përshkrimin dhe kushtet e punës për këtë pozitë mund të shkarkohen nga www.kpaonline.org/jobs apo mund të merren në të gjitha zyrat e AKP-së. Kandidatët e interesuar duhet të aplikojnë online përmes KPA web faqes:

<http://www.kpaonline.org/sq/jobs.asp>

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pa kompletuara mund të refuzohen. Për shkak të numrit të madh të aplikacioneve të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni Zyren e Burimeve Njerëzore përmes postës elektronike në: recruit@kpaonline.org.

Afati i fundit për të paraqitur aplikacionet është 14 Shtator 2011

KPA ZYRAT/OFFICES/KANCELARIJE KPA-a

Selia/Headquarters/Sedište: Perandori Justinian 5, Prishtinë/Priština, tel. (038) 249-918, fax. (038) 249-919; **Beograd:** Kosovska 49/8, tel. (011) 334-5513, fax. (011) 334-5314; **Gjilan/Gnjilane:** Lidhja e Prizrenit 114, tel. (0280) 320-289, fax. (0280) 324-067; **Mitrovicë/Mitrovica:** Mbretresha Teuta/Nenadović 14 (vis a vis UN HQ/Jugobanka), tel. (028) 530-136, fax. (028) 530-139; **Pjesa Veriore e Mitrovicës/Severni deo Mitrovice:** ndërtesa e AKM-së (afër Stacionit Verior të Policisë së UNMIK-ut)/Trepca-building/zgrada KPA (pored UNMIK-ove Policijske Stanice Sever); **Pejë/Peć:** Mbretresha Teute 85, tel.(039) 431-668, fax. (039) 432-970; **Prishtinë/Priština:** Rexhep Luci/Goleška 2, tel. (038) 225 473, fax.(038)244-854; **Prizren:** "William Walker" në Prizren (at EULEX base) Tel: (038) 760 610/ (038) 760 611; **Skopje:** Vinichka Street No. 10 (CDRIM-building), first floor, Telephone: +389 71 886 564; **Beograd/Belgrade:** UNHCR Property Office, *Visegradska 23, Tel: 011/362-13-93; 362-13-94 Fax:011/361-27-48;* **Podgoricë/Podgorica:** Crnogorskih Serdara bb, tel. (081) 624-216;

www.kpaonline.org

e themeluar nga rregullorja e UNMIK-ut 2006/10 - established by UNMIK Regulation 2006/10 - osnovana pod UNMIK Uredbom 2006/10
e përkrahur nga - supported by - podržavaju

